



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2403 / prot.
A

Elbasan, më 03.11.2025

VENDIM

Nr. 68, datë 03.11.2025

"PËR

**SHPLLJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR NJË ANËTAR PËRFAQËSUES TË
STUDENTËVE NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN
E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

Vendosi:

1. Të shpallë procesin e regjistrimit të aplikantëve për një anëtar përfaqësues të studentëve në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët aktivë që ndjekin studimet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
3. Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të aplikimit është data 11.11.2025.
4. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë si më poshtë:
 - Kërkesa për aplikim;
 - Vërtetim që aplikanti është student aktiv.
5. Dokumentet të dorëzohen në sekretarinë e Senatit Akademik ose në Zyrën e Protokollit të Universitetit brenda datës 11.11.2025.
6. Vendimi të afishohet në ambientet e njësive kryesore si dhe të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Prof.Dr. Elvira Fetahu

